



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.,

Tiranë më _____. _____. 2025

V E N D I M

Nr. 04, datë 19.05.2025

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË VKD NR. 23, DATË 30.09.2024 “PËR MËNYRËN E
PËRDORIMIT TË KOMISIONIT TË PËRFITUAR NGA AKEP SI AGJENT
TATIMOR, PËR VITIN 2025”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP),
me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 19 maj 2025, në zbatim të procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me vendimin nr.7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues, e ndryshuar dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Për një ndryshim në VKD të AKEP, datë 23.09.2024 “Për mënyrën e përdorimit të komisionit të përfituar nga AKEP, si agjent tatimor, për vitin 2025”*

BAZA LIGJORE:

1. Pikat 1, të nenit 14 dhe 15, neni 17 i ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Vendimi i Këshillit Drejtues, nr. 93, datë 10.12.2018, “Për vendosjen e rregullave për mënyrën e buxhetimit, raportet e përdorimit dhe kompetencat e Këshillit Drejtues në

miradministrimin dhe menaxhimin e komisionit të përfutur nga AKEP në cilësinë e tij Agjent Tatimor, për mbledhjen e tarifave kombëtare”.

3. Vendimi i Këshillit Drejtues, nr. 23 datë 30.09.2024, “Për mënyrën e përdorimit nga AKEP të komisionit që do të përfitohet si Agjent Tatimor për vitin 2025”;
4. Vendimi i Këshillit Drejtues, nr. 24 datë 30.09.2024, “Për caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe Projekt Buxhetin e vitit 2025 të AKEP” ;
5. Vendimi i Këshillit Drejtues, nr. 32 , datë 23.12.2024, “Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2025”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni shpjegues i projektvendimit, i përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar (DBMF).
2. Projektvendimi i arsyetuar,

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar

V Ë R E N:

Ligji nr. 9975/2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, në nenin 11, germa “e”, përcakton në llojin e tarifave të shërbimit, tarifën për shërbimet e radiokomunikimit e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

Në vijim, udhëzimi i përbashkët i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe të Kryetarit të KD-së së AKEP, nr. 30, datë 23.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit”, i ndryshuar, ngarkon AKEP, si agjent tatimor për mbledhjen e kësaj tarife, llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin e të ardhurave nga tarifa për shërbimet e radiokomunikimit në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore, e më pas në Buxhetin e Shtetit. Kjo tarifë, sikundër përcaktohet në pikën 4 të këtij udhëzimi, është vjetore dhe deklarohet nga agjenti mbi bazë mujore.

Mbledhja dhe transferimi i tarifave dhe taksave në Buxhetin e Shtetit, është detyrë që e kryen agjenti tatimor, referuar përcaktimeve ligjore parashikuara në pikën 1, germa “b”, të nenit 5, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilave *agjenti tatimor është personi që mbledh dhe transferon në Buxhetin e Shtetit tatimet dhe taksat.*

AKEP, për shërbimin e kryer, përfiton 5% komision të vetëllogaritur prej tij, mbi masën e tarifave të arkëtuara, dhe transferon 95% të vlerës totale, në Buxhetin e Shtetit.

Përdorimi i komisionit nga AKEP, si agjent tatimor, bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 3 të nenit 8, të ligjit nr. 9975/2008, të sipërcituar dhe pikës 1.3 të Udhëzimit nr. 26/2008 “Për Taksat kombëtare”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Komisionet e përfituara përdoren:

- a) *në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;*
- b) *në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave;*

c) për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave”.

Mbajtur parasysh 3 (tre) kriteret e përcaktuara më sipër, me VKD nr. 93/2018 të sipërcituar, janë miratuar rregulla për përcaktimin, menaxhimin dhe mirëadministrimin e komisionit të përfutur nga AKEP në cilësinë e tij si agjent tatimor dhe me VKD nr. 23/2024 të sipërcituar, është përcaktuar raporti i përdorimit të komisioneve që do të përfitojnë nga mbledhja e kësaj tarife, si më poshtë:

1. për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave”, në masën 40% të vlerës së parashikuar;
2. në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në masën 60% të vlerës së parashikuar.

Në vijim me VKD nr. 32, datë 23.12.2024 për “Miratimin e buxhetit të AKEP 2025”, është vendosur se nga vlera 25.6 milion lekë e parashikuar të përftohet nga AKEP si Agjent Tatimor, për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin e tarifës së radio komunikimit, vlera prej 15.36 milion lekë do të përdoret si shpërblim për vështirësi në punë për vitin 2025, për punonjësit e AKEP.

Referuar ligjit nr. 9975/2008 dhe Udhëzimit nr. 26/2008 “Për Taksat kombëtare”, i ndryshuar, nuk përcaktohen raporte për mënyrën e përdorimit të komisionit nga agjenti tatimor dhe KD ka tagrin e miratimit të raporteve apo edhe ndryshimit të këtyre raporteve në varësi të nevojave të institucionit.

KD vëren se dhënia e të drejtave të përdorimit të rrjeteve me shpejtësi të lartë (5G) për herë të parë në muajin tetor të vitit 2024 ka sjellë nevojën për punë dhe angazhim shtesë të stafit të AKEP, detyra që lidhen me përllogaritje të reja për shkak të autorizimeve të lëshuara, vjeljen e taksave dhe tarifave kombëtare si dhe derdhjen e shumave në Buxhetin e Shtetit. Gjithashtu, implementimi 5G është pasuar me revokime të lidhjeve fikse të operatorëve të mëdhenj e cila automatikisht kërkon punë shtesë për drejtoritë përkatëse që AKEP, që lidhen me këtë proces (rilllogaritje, përditësim të sistemeve të brendshme teknike dhe financiare, derdhje në Buxhetin e Shtetit etj)

Në këtë këndvështrim, mënyra e përdorimit të komisionit nga agjenti tatimor, vlerësohet të realizohet duke i dhënë më shumë prioritet pikës 1.3 , germa “a. në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi”, të Udhëzimit nr. 26/2008 “Për Taksat kombëtare”, i ndryshuar, duke përcaktuar raportet të reja të përdorimit të komisionit të përfutur si agjent tatimor.

Për sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP, në referim të dispozitave ligjore të sipërcituara, dhe duke analizuar nevojat në përdorimin e komisionit të përfutur si agjent tatimor për mbledhjen e tarifës së radiokomunikimit, vlerëson tërësisht legjitime dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi ndryshimin e raportit në përdorimin e këtij komisioni.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikat 1 të nenit 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e pikës 1, të VKD nr. 23, datë 30.09.2024, “Për mënyrën e përdorimit nga AKEP të komisionit që do të përfitohet si agjent tatimor për vitin 2025”, me përmbajtje si më poshtë:
 - a) *në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në masën jo më pak se 60% e vlerës së parashikuar;*
 - b) *për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave”, në vlerën e mbetur pas kryerjes së shpërndarjes së fondit jo më shumë se 40% e vlerës së parashikuar.*
2. Ngarkohet Drejtoria përgjegjëse e Financës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka